




REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. 2-D/DPK	Br. Prot. 01-528/2013
Dep. 2-D/DPK	Prot. No. 01-528/2013
Nr. ffaq.	Data
Broj stranica 02	Datum 20-02-2013
Nr. pages	Date
	20-02-2013
PRISTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë **31.01.2013**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-3634/12, për ztr. *Kujtim Xhelili* – Anëtar i Bordit të Kompanisë së Ujësjetës Rajonal “KUR Prishtina”, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që dëshmojnë për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-3634-12, për Zyrtarin e lartë, ztr. Kujtim Xhelili – Anëtar i Bordit të “KUR Prishtina”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari të lartë, ztr. Xhelili së pari i është bërë shkresa e parë njoftuese (Z.D./DPK-01-4027).

Pas pranimit të kësaj shkrese zyrtari i lartë, ztr. Xhelili, është paraqitur në Agjencinë kundër Korrupsionit dhe në takim me zyrtarët e Agjencisë ka sqarur aktivitetet e tija si anëtar Bordi “KUR Prishtina” dhe si Kryesues i Kuvendit Komunal të Shtimjes.

Pos këtij takimi, zyrtari i lartë, ztr. Xhelili ka dërguar edhe një shkresë zyrtare në adresë të Agjencisë kundër Korrupsionit (DPK/DPKI -03-4623) në të cilën ka sqaruar këto aktivitete.

Konform faktit se Kompania Publike "KUR Prishtina" nuk përfshinë Regjionin e Shtimjes, pastaj duke pas parasysh Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të interesit (Nr. 04/L-051), si dhe Ligjin për Vetëqeverisjen lokale (Nr.03/L-040) konkretisht pikat nga Neni 38 dhe pikat nga Neni 41 i këtij ligji, kemi konstatuar se nuk ka kufizime të tilla që do të shkaktonin papajtushmëri në mes të këtyre dy funksioneve.

Për zyrtarin Xhelili në këtë rast vlejné kufizimet për rastet e konfliktit të interesit të parapara në Ligjin mbi Vetëqeverisjen lokale, si dhe detyrimet nga Ligji për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, në ato raste kur ushtrimi i këtyre funksioneve mund të sjell ndonjë situatë eventuale të konfliktit të interesit "rast për rast".

Atëherë, në bazë të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit, në këto situata Zyrtari është i obliguar që të bëjë deklarinimin paraprak, "rast për rast" të interesave të tij private (Neni 13 i Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik).

Vet deklarimi si rregullë bëhet me shkrim, kur zyrtari i lartë përfshihet në një vendimarrje për ndonjë çështje të caktuar (Neni 13 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 04/L-051).

Statuti dhe rregullorja e punës përcaktojnë masat për përjashtimin e anëtareve nga procesi i marrjes së vendimeve dhe nga procedurat administrative, aty ku kanë konflikt interesi" (Neni 38, paragrafi 4, i Ligjit Nr.03/L-040, Për Vetëqeverisjen lokale).

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

